

UDHËZIM
Nr.38, datë 2.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.35, DATË 5.11.2010 “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2010-2011”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 13.10.2010 “Për kuotat e pranimeve të institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”,

UDHËZOJ:

1. Pika 8 e udhëzimit nr.35, datë 5.11.2010 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ndryshon si më poshtë:

“8. Kandidatët që do të aplikojnë për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në një program të dytë studimi, të dorëzojnë në sekretaritë mësimore, përveç dokumenteve të pikës 5, edhe fotokopje të noterizuar të diplomës së lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë ose fotokopje të noterizuar të ndonjë diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj